

Informacione mbi vaksinimin e Covid-19

Të dashur banorë të Schaffhausen-it

Vaksinohuni!

Do të mbron veten dhe familjen tuaj nga një smundje e rëndë.

Pandemia e Koronës është përhapur shumë në Zvicër, shumë njerëz janë sëmurë, një pjesë e tyre edhe shumë rëndë. Për fat kemi Vaksinat, të cilat na mbrojnë nga sëmundjet. Për vaksinim të plot janë të nevojshme dy injeksione, mbrenda katër javëve. Pas kësaj krijohet një mbrojtje e mirë edhe kundër variantës dominuese-Delta.

Vaksina tolerohet mirë. Efektet e mundshme anësore (dhimbje në vendin e shpimit, dhimbje koke, zjarë) janë zakonisht të lehta dhe nuk zgjasin gjatë. Këto efekte anësore janë në të shumtën e rasteve më pak të rënda sesa nëse sëmureni nga korona.

Efekte anësore të rënda me pasoja afatgjate apo pasoja të më vonshme deri më tani nuk janë paraqitur dhe nuk pritet që të paraqiten.

Më në fund ne duam që ta kalojmë këtë pandemi dhe ti rikthehemi normalitetit. Për këtë na duhet vaksinimi.

Vaksinimi është falas.

Certifikata e Vaksinës na e lehtëson udhëtimin jashtë vendit dhe garanton qasjen ndaj manifestimeve të ndryshme.

Gëzohemi të ju shohim në qendrën për vaksinim Charlottenfels, ju mirëpresim. Është shumë e thjeshtë dhe sështë aspak e komplikuar për të marrë vaksinën, me ose pa Termin.

Me respekt

Ekipi i Covid-19

Si mund të vaksinohem?

Ju lutemi të merrni Kartën e Identitetit dhe Kartelën e sigurimit me veti.

Vaksinimi pa Termin:

Ju mund të vini në qendrën për Vaksinim (Walk-in) në këtë kohë:

- të hënë 17 – 20 Uhr
- të martën 17 – 20 Uhr
- të premten 14 – 20 Uhr
- të shtunën 9 – 13 Uhr

Regjistrimi për të lënë takim nëprmet numrit të telefonit **052 632 65 57**

Regjistrimi elektronik për termin ju mundëson të zgjidhni vet Terminin:

Risi është që nën linkun www.sh.ch/corona mund të zgjidhni individualisht sipas dispozicionit kohën dhe datën e Vaksinimit tuaj të parë dhe të dytë

Edhe pse vaksinimi mbron nga smundjet, është e rëndësishme, që të vazhdoni t'iu përmbaheni rregullave të rekomanduara për higjenë dhe sjellje.